

Nr. ____ -K-20_

KONTRATË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE POSTARE



E lidhur në Prishtinë, më: ____/____/20____ në mes të palëve kontraktuese:

1. Postman SH.P.K. përfaqësohet nga drejtori z.Albin Rahmani në bazë të ligjit Nr.06/L-038, për shërbimet postare në Republikën e Kosovës dhe Rregulloreve të nxjerra nga ARKEP të nenit 16 të Rregullores nr.41 ofruesi i shërbimit postar lidh këtë kontratë me :

2. _____ me numër të letërnjoftimit: _____ duke njojur dhe kuptuar këtë shërbim që ofron Kompania Postare, me vullnet dhe dakordim pajtohen me dispozitat dhe përbajtjen e kësaj marrëveshje në këtë mënyrë:

Neni 1

Postman SH.P.K. ofron dhe merr përsipër të kryej për llogari të klientit Shërbime Postare dhe Transportin e shërbimeve brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës me pagesë te pritësi.

Neni 2

Kompania Postare detyrohet duke u bazuar në këtë marrëveshje t'i siguroj klientit shpejtësinë dhe cilësinë maksimale të mundëshme gjatë kryerjes së shërbimit.

Marrja dhe dorëzimi i sendeve do të bëhet në vendin e përgjedhur nga klienti me pëlqimin e tij brenda orarit 08:00 am-20:00 pm nga e hëna -shtunen. Procesi i shpërndarjes dhe marrjes në dorëzim të dërgesave do të kryhet brenda orarit prej 24 orësh nga momenti i dorëzimit të dërgesave në zyret tona.

Kompania postare do të bëj përpjekje maksimale për të arritur efikasitetin e shpërndarjes së mallrave duke telefonuar për të informuar klinetin apo pritësin për dorëzimin e sendit-ve. Në rastet kur numri kontaktues i telefonit dhe adresa nuk janë të sakta, atëherë kompania Postare informon klientin duke kërkuar informacion shpeshtë për orientim të saktë, në të njejtën kohë do të presë në periudhë kohore prej 5-10 minuta për ndonjë përditësim të informacionit.

Kompania Postare është e detyruar të ruaj sekretin e korrespondencës, si dhe të kujdeset për trajtimin konfidential të çdo informacioni që merr në lidhje me veprimtarinë e klientit.

Kompania Postare detyrohet të respektoj imperaktivin për mbrojtjen e të dhënavë të klientit në dispozitat ligjore të ligjit, për shërbimet postare - Transporti në Republikën e Kosovës.

Kompania postare në web faqen e saj zyrtare do të publikoj gjendjen e statistikave të dërgesave të ndërmarrjeve bashkëpunuese ku në çdo kohë mund të kenë qasje për t'i parë dhe ditur pasqyrën reale të dërgesave të tyre.

Neni 3

Klienti detyrohet t'i ofroj dhe sigurojë Kompanisë Postare gjithë informacionin e kërkuar përsa i përket të dhënavë të nevojshme për kryerjen e shërbimit si: Qytetin, Vendbanimin, Emërtimin e rrugës dhe numrin e qasshëm kontaktues të telefonit, të gjitha këto elemente për të ndihmuar kryerjen e shërbimit në parametrat e përcaktuar.

Klienti mund të kërkoj sigurimin e mallit apo sendeve rasti pas rasti konformë legjislacionit mbi sigurimin e mallit në udhëtim, po ashtu ai mund të kryej edhe vetë sigurimin e mallit kur e sheh të arsyeshme. Në çdo rast, sigurimi i mallit apo sendeve mbetet detyrim i Klientit.

Kur malli apo sendi-et janë pranuar me postë në gjendje të rregullt nga klienti pasi i është dhënë mundësia punëtorit të kompanisë për ta parë produktin se në çfarë gjendje është mënyra e paketimit dhe produkti i cili gjendet në të duke konfirmuar dhe pranuar se gjithçka është në rregull, gjithashtu duke pasur parasysh edhe specifikat e ndjeshme të produktit dhe pëson dëmtimë të pjesshme ose tërësore apo humbje nga pakujdesia e punëtorit, Kompania Postare do të dëmshpërbuje Klientin me shumën e tërësishme të atij produkti të cekur paraprakisht në faturë.

Paketimi i mallit apo sendit është përgjegjësi ekskluzive e klientit apo ndërmarrjes bashkëpunuese, të cilët paketimin e mallit apo të sendit duhet ta bëjnë në atë mënyrë duke ju përshtatur specifikave të produktit.

Klienti apo ndërmarrja bashkëpunuese janë përgjegjës për dëmet që rrjedhin si rezultat i mospaketimit të duhur të mallrave të tyre. Klienti apo ndërmarrja bashkëpunuese privohet nga e drejta e dëmshpërbimit për çdo dëmtim që ndodh gjatë transportit si rezultat i të metave në paketim.

Klienti në çdo rast duhet ta shoqëroj mallin apo sendin me faturë tatimore.

Neni 4

Në rastin kur palët apo subjektet (ndërmarrja bashkëpunuese dhe klienti i ndërmarrjes) kryejnë shitëblerje ndërmjet vete, për çdo mosmarrëveshje ndërmjet tyre Kompania Postare nuk merr asnjë përgjegjësi juridiko-civile, sepse ne jemi palë e tretë që ofrojmë vetëm shërbimin e transportit tek klienti i ndërmarrjes.

Po ashtu kur faqja apo rrjeti komunikues i ndërmarrjes bashkëpunuese ndërprenë dhe blokon çdo komunikim me blerësin duke mos ju përgjigjur në thirrjet e tij apo të saj, në këtë rast blerësi duhet të kërkojë sqarim dhe përgjegjësi nga shitësi apo ndërmarrja bashkëpunuese për mos përgjigje ndaj

thirrjes së tij.Çdi iniciativë dhe tendencë për të atakuar dhe sulmuar stafin dhe punonjësit e Kompanisë Postare për mos komunikim ndërmjet palëve të sipërmendor,Kompania Postare nuk do të përfshihet në raportet ndërmjet tyre,por do të marrë veprime racionale duke ja kther mjetet(paratë) blerësit,rrjedhimisht, ndërmarrja bashkëpunuese apo faqja e saj do ta bëjë shpagimin për dëmin e shkaktuar ndaj Postës.

Neni 5

Kompania Postare mban përgjegjësi mbi humbjen ose dëmtimin e dërgesave të lejuara deri në masën që e kushtëzon Rregullorja e Kompanisë Postman SH.P.K., kjo rregullore tregon qartë masën dhe mënyrën e kompenzimit në rast të dëmtimit gjatë dërgesës.

Neni 6

Kompania Postare ndalon retepësish dhe nuk ofronë shërbime të ndaluara me ligj, si elementeve të trafikimit me narkotik,armëve..etj..përveç rasteve kur ligji e lejon shprehimisht një gjë të tillë.

Në rast se klienti apo ndërmarrjet bashkëpunuese ofrojnë dërgesën e tyre të paketuar me sende të ndaluara me ligj në Republikën e Kosovës duke mos e njoftuar agjentin e shpërndarjes apo Kompaninë Postare mbajnë përgjegjësi juridike dhe penale për veprimet e tyre.

Kompania Postare ofron shërbimin e transportit për çdo dërgesë të paketuar ndaj klientit apo ndërmarrjes bashkëpunuese,duke u distancuar nga çdo lloj përgjegjësie juridike dhe penale për atë se çka gjindet brenda paketimit.

Kompania Postare ofron shërbimin e transportit për çdo dërgesë të paketuar ndaj klientit apo ndërmarrjes bashkëpunuese,duke u distancuar nga çdo lloj përgjegjësie juridike dhe penale për atë se çka gjindet brenda paketimit.

Neni 7

Kompania Postare mban nga mjetet e arketuara prej pritësit për llogari të klientit pjesën e shërbimit postar që është rënë dakord në bazë të marrëveshjes sipas listës së çmimeve.

Kompania Postare derdhë apo transferon në llogarinë e klientit pjesën e mbetur brenda 48 orëve nga momenti i arkëtimit në rast që ka pagesë për dërgesat lokale brenda territorit të Republikës së Kosovës.Ndërsa për dërgesat ndërkombëtare apo jashtë Republikës së Kosovës që kanë pagesë afati për derdhjen apo transferimin e mjeteve në llogarinë e klientit është 10 ditë.

Neni 8

Për çdo ndryshim të kësaj kontrate për të cilën palët bien dakord rregullisht, do të formohet gjithmonë me shkrim duke e nënshkruar dhe vulosur rregullisht.

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin prej ose në lidhje me zbatimin e kontratës, do të zgjidhen nga palët me mirëkuptim dhe në përputhje me nenet e kësaj kontrate.

Në rastet kur nuk arrihet një zgjidhje e tillë, palët do ti drejtohen organeve të Gjykatës për zgjidhjen e konfliktit.

Neni 9

Afat i vlefshmërisë së kësaj kontrate do të jetë 12(dymbëdhjetë)muaj nga dita e lidhjes së saj me mundësi vazhdimi edhe për 12(dymbëdhjetë) muaj të tjera.

Neni 10

Ndryshimi i përfaqësuesve të palëve autorizuese për kontraktim nuk sjell ndryshime në kontratë.

Në këtë kontratë janë paraqitur të gjitha elementet e vlefshmërisë, pëlqimi i palëve që marrin përsipër detyrime, indikatorët e ligjshëm ku mbështetet detyrimi, objekti për formën dhe lëndën e kontratës.Prandaj kjo kontratë mbetet në zbatim efektiv deri në përfundim të saj apo kur të zgjidhen ligjërisht nga palët.

Kjo kontratë përpilohet në 2(dy) ekzemplarë identike në gjuhën shqipe apo në gjuhën tjetër zyrtare të klientit që flet.

Palët pasi që kuptuan dhe njohën përmbajtjen e kësaj kontrate e nënshkruajnë me vullnetin e tyre të plot dhe të lirë.

PALËT KONTRAKTUESE

Postman SH.P.K.

Albin Rahmani(drejtore)



Numri i telefonit dhe nënshkrimi

Prishtinë ____/____/20____